



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:269423

Datë: 04.10.2024

Numri i dokumentit: 06251595

K.DH.SH.II.nr.1071/24

GJYKATA KOMERCIALE - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Dren rogova dhe Ramush Bardiqi, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Exclusive” ShPK me seli në Gjilan, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Faton Qirezi, avokat me seli në Prishtinë, kundër të paditurës së parë Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë dhe të paditurës së dytë Ministria e Shëndetësisë me seli në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.58/22 të datës 25.03.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 03.10.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit “Exclusive” ShPK me seli në Gjilan, e datës 05.04.2024 ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.58/22 të datës 25.03.2024, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Administrative, me aktgjykimin e atakuar KA.nr.58/22 të datës 25.03.2024, nën pikën I. të dispozitivit të aktgjykimit, ka vendosur, Refuzohet në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit “Exclusive” ShPK me seli në Gjilan, me NRB 70479274, kundër të paditurës së parë Organi Shqyrtues i Prokurimit dhe të paditurës

së dytë Ministria e Shëndetësisë, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit PSH.nr.271/2012 të datës 20.03.2018. Nën pikën II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë paditësi, përmes përfaqësuesit së autorizuar, për shkak të: shkeljes së dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që Dhoma e Shkallës së Dytë ta aprovojë ankesën si të bazuar dhe ta ndryshojë aktgjykimin e ankimuar duke e aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar.

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e kundërshtuar të Panelit Shqyrtues të Prokurimit Publik, PSH.nr.271/2012 të datës 20.03.2018, nën pikën I të dispozitivit të vendimit, Refuzohet ankesa e OE “Exclusive” ShPk me seli në Gjilan, lidhur me aktivitetin e Prokurimit me titull: “Furnizim me Infuzione” me nr. prokurimit MSH/206/12/047/111, i iniciuar nga autoriteti kontraktues Ministria e Shëndetësisë. Nën pikën II, Vërtetohet vendimi i OSHP-së, PSH. Nr. 271/12 i datës 08.10.2012, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Furnizim me Infuzione” me nr. prokurimit MSH/206/12/047/111 i iniciuar nga autoriteti kontraktues Ministria e Shëndetësisë. Nën pikën III, Zbatohet vendimi i Gjykatës Themelore-Departamenti për Çështje Administrative-Prishtinë me A.nr.1323/2012 i datës 21.12.2018.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës Paneli Shqyrtues i Prokurimit Publik, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 19.04.2018, me pretendim se vendimi i të paditurës është i pa drejtë dhe i paligjshëm.

Dhoma e Shkallës së Parë pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër vendimit të paditurës dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u

bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e refuzon si të pa bazuar. Me arsyetim se: Gjykata ka vlerësuar se kriteri i eliminimit të paditësit nga aktivitetin e prokurimit, me titull: "Furnizim me Infuzione" me nr. prokurimit MSH/206/12/047/111 ishte mosplotësimi i kriterëve të përcaktuara në dosjen e tenderit, e që sipas njoftimit për kontratës në dosjee e tenderit në specifikimet teknike, në seksionin 9.1 kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale, pika dy: kërkohet që barnat duhet të kenë Cerfitikatën për Marketing për Kosovë (5 vjeqare). Është jo kontestuese se paditësi kishte ofertuar me produkte nga prodhuesi "Zdravle Aktavis" – Leskovc, për të cilat posedon Cerfitikatën për Marketing për Kosovë me numer MA 0420/151208, të datës 15.12.2008 me afat të vlefshmërisë deri me datë 15.12.2013, por kjo certifikatë është pezulluar nga Agjencioni Kosovar për Produkte Medicinale, përmes e-mailës së datës 19.01.2012 kur paditësi "Excluzive" sh.p.k. ishte njoftuar me vendimin e Ministritë së Shëndetësisë për pezullim të çertifikatave të autorizim marketingut për prodhuesit e kompanive serbe: "Zdravle Akavis" – Leskovc Serbia, "Hemofarmi" Serbia dhe "Jugoremida" – Serbia. Ndaj këtij vendimi nuk ka asnjë dëshmi që është kontestuar apo është vlerësuar ligjshmëria vendimit të datës 19.01.2012 por paditësi pa e kontestuar vendimin për pezullim të çertifikatave të autorizim marketingut për prodhuesit e kompanive serbe: "Zdravle Akavis" – Leskovc Serbia, "Hemofarmi" Serbia dhe "Jugoremida" – Serbia, e konteston tani vendimin PSH.nr. 271/2012, të datës 20.03.2018 lidhur me aktivitetin "Furnizim me Infuzione" me nr. prokurimit MSH/206/12/047/111, me arsyetim se nuk e merr parasysh një veprim dëmtues të paditurës së dytë duke ju referuar Kontratës për aktivitetin e prokurimit me nr. 71300/10/647/111 me titull "Furnizim me barna dhe material shpenzues" ndërmjet MSH dhe Kontraktuesit Exklusiv SH.P.K - e të cilën gjykata ka vlerësuar se nuk ka të bëjë fare me këtë aktivitet të prokurimit. Gjykata ka rikujtuar se paditësi pretendimet për dëmtim që rrjedhin nga Kontrata për aktivitetin e prokurimit me nr. 71300/10/647/111 me titull "Furnizim me barna dhe material shpenzues" ndërmjet MSH dhe Kontraktuesit Exklusiv SH.P.K. mund të kontestoj në procedure kontestimore civile por që në këtë rast konstatohet arsye e eliminimit të paditësit nga aktivitetin e prokurimit, me titull: "Furnizim me Infuzione" me nr. prokurimit MSH/206/12/047/111 ishte mosplotësimi i kriterëve të dosjes së tenderit, sepse Cerfitikata për Marketing për Kosovë me numer MA 0420/151208, të datës 15.12.2008 me të cilën paditësi kishte ofertuar me produkte nga prodhuesi "Zdravle Aktavis" – Leskovc, ishte pezulluar sipas vendimit/njoftimit të Ministrisë së Shëndetësisë për pezullim të çertifikatave të autorizim marketingut për prodhuesit e kompanive serbe: "Zdravle Akavis" – Leskovc Serbia, "Hemofarmi" Serbia dhe "Jugoremida" – Serbia. Prandaj, Gjykata ka vlerësuar se nga provat e administruara nuk janë vërtetuar pretendimet e paditësit, vendimi i kundërshtuar është në

përputhje me nenin Neni 47 të LPPA-së, sa i përket strukturës dhe i përmban të gjitha elementet e detyrueshme të aktit administrativ të shkruar si dhe arsyetimin konform nenit 48 të LPPA-së. Prandaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Qëndrimin juridik të Dhomës së Shkallës së Parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të cilat shkelje Dhoma e Shkallës së Dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Dhoma e Shkallës së Parë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative, si dhe në përputhje të nenit 8 të LPK-së, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e është e pa bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore se aktgjykimi i Dhomës së Shkallës së Parë është i përfshir me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) dhe neni 182 paragrafi 1 e lidhur me nenin 143 paragrafi 1 të LPK-së ngase aktgjykimi ka të meta të atilla për shkak të cilave ai nuk mund të ekzaminohet. Aktgjykimi i ankimuar nuk përmban arsyet për faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato pak arsye të cilat janë dhënë nga gjykata, jatë të pa qata, kontradiktore dhe pa mbështetje në provat dhe procesverbalet nga shkresat e lëndës dhe sidomos dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me kërkesën e paditësit. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoi, ngase ngase aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës administrative, e as me shkelje të tjera të cilat do të ndikonin në drejtëshmërinë dhe ligjshmërinë e aktgjykimit të goditur. Meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së, dhe LPK-së.

Lidhur me pretendimet ankimore se Dhoma e Shkallës së Parë ka bërë konstatim të gabuar të gjedjes faktike pasi që ndalimin e kontraktimit të produkteve medicinale është dashur ta konsideroj si një ndalesë për importim në të ardhmen dhe jo si një ndalesë e pjesëmarrjes në tender me produktet tashmë të kontraktuara dhe të cilat ishin në stoqe të paditësit, pikërisht për shkak të imponimit të importit nga Serbia nga ana e të paditurës së dytë. Kolegji pretendimet e tilla i vlerësoj si të paqëndrueshme për faktin se Cerfitikata për Marketing për Kosovë me numer MA 0420/151208, të datës 15.12.2008 me të cilën paditësi kishte ofertuar me produkte nga prodhuesi "Zdravle Aktavis" – Leskovc, ishte pezulluar sipas vendimit/njoftimit të Ministrisë së Shëndetësisë për pezullim të çertifikatave të autorizim marketingut për prodhuesit e kompanive serbe: "Zdravle Akavis" – Leskovc Serbia, "Hemofarmi" Serbia dhe "Jugoremida" – Serbia. Po ashtu nga paditësi nuk ka asnjë dëshmi që është kontestuar apo është vlerësuar ligjshmëria vendimit të datës 19.01.2012 por paditësi pa e kontestuar vendimin për pezullim të çertifikatave të autorizim marketingut për prodhuesit e kompanive serbe: "Zdravle Akavis" – Leskovc Serbia, "Hemofarmi" Serbia dhe "Jugoremida" – Serbia, e konteston tani vendimin PSH.nr. 271/2012, të datës 20.03.2018 lidhur me aktivitet "Furnizim me Infuzione" me nr. prokurimit MSH/206/12/047/111. Andaj, për këtë arsye Dhoma e Shkallës i vlerësoi si të pa bazuara pretendimet e paditësit sepse të njëjtat nuk kanë gjetur mbështetje në dispozitat ligjore materiale të cilat rregullojnë këtë çështje dhe nuk kanë qenë në përputhje me provat e administruara për të vendosur ndryshe në këtë çështje administrative.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore se për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës dhe për shkak të mosvërtetimit të saktë dhe të plotë të gjedjes faktike me ratin e marrjes së aktgjykimit të ankimuar ka ndodhur edhe zbatimi i gabuar i së drejtës materiale, ngase paditësi është eliminuar nga tenderi padrejtësisht për shkak të pjesëmarrjes në tender me pajisje medicinale të cilat asnjëherë nuk ishin nxjerrë jashtë qarkullimit juridik, por vetëm ishte ndaluar përkohësisht importi në të ardhmen. Ky kolegji këto pretendime ankimore nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të pa bazuara, përkatësisht të pa argumentuara me prova konkrete, ngase sipas vlerësimit kolegjit aktgjykimi i ankimuar i Dhoma e Shkallës së Parë është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij i janë dhënë arsyet të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë. Andaj, kolegji i vlerëson se edhe e drejta materiale është aplikuar drejtë, dhe se nuk është shkelur ligji në dëm të paditësit.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë të paditësit dhe lënies në fuqi të vendimit të paditurës, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura të njëpasnjëshme një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.1071/24, 03.10.2024

Kryetar i kolegjit,

Faton Bajrami